



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 301/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Jelena Stojanoviç – Drejtoreshë e Shërbimeve Komunale në Graçanicë, paraqitur kundër Subjekteve politike për shkak të vendosjes së posterëve në vende dhe rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet poshtë si e pa rregullt ankesa e Jelena Stojanoviç – Drejtoresh e Shërbimeve Komunale në Graçanicë .

Arsyetim

Me datën 21.10.2013, Jelena Stojanoviç, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon, se në rrugët kryesore të Komunës së Graçanicës në mënyr jo të rregullt janë vendosur posterët në të dy anët e rrugës në form cerade e cila është ngjitur në dy shtyllat e rrymës dhe ndriçimit, kështu që cerada është e vendosur shumë ulët e gjatë lëvizjes së kamionëve dhe autobusëve, mund të vie deri të shqyerja e ceradës e po ashtu mundë të dëmtohen edhe instalimet tjera . Gjithëashtu parashtruesi i ankesës thekson se reklama politike është e vendosur në afërsi të qendrës tregtar të Graçnicës si dhe në kthesen për fshatin Sushic. Parashtruesi i ankesës në këtë rastë konsideron se është dëmtuar prona Komunale për shkakë të mosrespektimit të ligjit për Zgjedhjet e përgjithëshme ku me këtë rastë subjektet politike dhe simpatizantet e tyre kan shkelur neni 33 të LZP-së. Për më tepër ka kërkuar që ti informoj subjekteve politike për tërheqjen e këtyre reklamave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e parregullt

Me ankesën e parashtruar nga Jelena Stojanoviç, pretendohet se është dëmtuar prona komunale në Komunën e Graçanicës për shkakë të vendosjes së posterëve në rrugë dhe në shtylla të rrymës dhe ndriçimit i cili rastë mund të shkaktoj dëmtimin e tyre, dhe krejt këto veprime janë të kryera nga subjektet politike dhe simpatizantët e tyre, mirëpo parashtruesi i ankesës nuk e ka specifikuar kryesin se kush e ka kryer veprën e precizuar saktësisht se nga kush janë shkaktuar këto veprime konkrete.

PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu shqyrtuar, prandaj ankesa vlerësohet si e parregulltë bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe procedurave të PZAP, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 301/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*